



TË KUJDESEMI PËR SIGURINË



Të nderuar qytetarë,

Policia e Kosovës është e përkushtuar që përmes bashkëpunimit dhe komunikimit me ju të ndihmojë në rritjen e sigurisë në bashkësinë tuaj.

DISA KËSHILLA PËR VETËSIGURINË TUAJ

MASAT E VETËSIGURISË

Thyerjet e shtëpive dhe vjedhjet janë veprat më të shpeshta që kryhen nëse shtëpia ose banesa juaj për një kohë të gjatë është e zbrazët për shkak të pushimit ose ndonjë udhëtimi dhe masat parandaluese mund të jenë:



- Mos t'u tregoni të gjithëve se do të udhëtoni diku;
- Të hollat dhe sendet me vlerë mos t'i lini në shtëpi, depononi në trezorin tuaj në bank;
- Ta shënoni numrin serik të sendeve të shtrenjta p.sh. mall i amvisërisë;
- Çelësin e shtëpisë ose banesës mos ta vendosni nën tepih apo nën vazot e luleve;
- Ta vendosni ndriçimin nga jashtë siç është: ndezja automatike apo ndriçimi me sensor;

SI T'I PARANDALOJMË VJEDHJET E VETURAVE DHE VJEDHJET NË VETURË:

- Kur të parkoni veturën, mos i lini dokumentet e veturës brenda saj;
- Vendosni alarmin dhe mjetin e bllokadës në timonin e veturës;
- Mos lini në veturë sende të vlefshme dhe aty ku duken;
- Gjithmonë mbyllni të gjitha dyert e veturës;
- Mos e parkoni veturën në vende ku nuk duket nga të tjerët;
- Kur ta parkoni veturën gjatë natës, aktivizojeni alarmin nëse e posedoni.



SA MË PAK ARMË, MË PAK TRAGJEDI



GJUAJTJA ME ARMË NË DASMA SJELL RREZIQE:

- Mos lejoni që në dasmën tuaj të gjuajë dikush me armë, raportoni në Polici;
- Nëse vëreni dikë se posedon armë, raportoni në Polici;
- Çdo shkrepje e armës, rrezikon qytetarët, çdo plumb mund ta godasë dikë.

Mos e prishni festën!
Festoni me zemër,
jo me armë!

SHKAKTIMI I ZJARREVE

**Zjarret janë rreziqe reale!
Mos lejoni që t'ju ndodhin!**



- Mos e leni stufën të ndezur;
- Mos e ndizni cigaren në divan;
- Rregullisht i kontrolloni instalimet elektrike;
- Mbani shkrepësen larg fëmijëve.
- Mos gjuani cigare të ndezura në fusha;
- Mos ndizni zjarre në barishte, afër pyjeve;
- Mos ndizni skarën në afërsi të pyjeve;
- Mos i hidhni cigaret e ndezura nga vetura.



**Kontakti me Policinë:
Numrin 192 si dhe Aplikacioni 'Lajmëro Policinë'**

Botimi i fletushkës u mundësua nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë me përkrahje financiare nga:

